



Open
Government
Partnership



Gjetjet kryesore & Rezultatet
Raporti i Monitorimit/Raporti i Vetëvlerësimit
Plani Kombëtar i Veprimit 2020-2022

OGGP

Shtator 2021

GJETJET KRYESORE TË RAPORTIT TË MONITORIMIT/VETË-VLERËSIMIT TË PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT OGP PËR SHQIPËRINË 2020-2022

FACTSHEET: Progresimi i arritur dhe zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit OGP 2020-2022

Qeveria e Shqipërisë ka shprehur vazhdimisht besimin dhe angazhimin e qartë për perspektivën e Shqipërisë në nismën e Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP).


Parimet e OGP-së janë udhërrëfyes për të promovuar demokracinë, sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave themelore, të cilat janë gjithashtu motorët kryesorë të integritetit ekonomik dhe perspektiva thelbësore për nxitjen e transparencës, hapjes dhe gjithëpërfshirjes.

Megjithatë, është gjithashtu e qartë se efektiviteti i procesit të përgjithshëm të OGP-së dhe i zbatimit të planit të tij të veprimit duhet të përmirësohet më tej. Ndërsa drejtimi strategjik i politikave mbetet më i vlefshëm se kurrë, do të duhet një vëmendje më e spikatur në respektimin e standarteve. Pavarësisht reformave të njëpasnjëshme, siç është qasja e re në luftën kundër korrupsionit, drejtësia e hapur, qeverisja dixhitale, transparenca fiskale dhe pronësia përfituese, procesi duhet të bashkërendohet konform standarteve të OGP-së. E rëndësishme mbetet krijimi i besimit tek të gjithë aktorët duke e përmirësuar në këtë mënyrë procesin, me qëllim bërjen më efektiv. Prosesi do të duhet të bëhet më i qëndrueshëm, më i besueshëm, bazuar në kritere objektive dhe kushtëzimet rigoroze pozitive dhe negative, duke e kthyer në këtë mënyrë në një proces dhe reformë më dinamike.

Komponentët kryesorë të Planit të Veprimit të OGP-së 2020-2022 janë: reforma antikorrupsion, qeverisja dixhitale, drejtësia e hapur dhe qeverisja fiskale. Këto komponentë afatmesëm janë shtyllat kryesore të zbatimit të planit të veprimit. Plani i Veprimit parashikon angazhime specifike, masa prioritare dhe produkte/milestones që duhen arritur për të përmbushur këto komponentë, sipas afateve të detajuara në Planin e Veprimit të OGP-së. **Plani i Veprimit OGP 2020-2022, duke pasur një qasje ndër-sektoriale, bazohet në parimin e koordinimit midis institucioneve për të arritur objektivat e përfshira në nivel të lartë në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritet, SKZHI duke zbatuar në këtë mënyrë një qasje sistemike dhe të integruar.**

Plani i Veprimit 2020-2022 përmban 52 produkte/milestones në total dhe përfshin 5 udhëheqës pika fokale, të cilët bashkërendojnë së bashku për më shumë transparencë, llogaridhënie dhe efikasitet. Masat prioritare të këtij plani veprimi janë forcimi i transparencës së autoriteteve publike, rritja e shërbimeve publike online në mënyrë progresive, duke filluar nga zbatimi i instrumenteve antikorrupsion në administratën publike (planet të integritetit), forcimin e bashkëpunimit të autoriteteve dhe zbatimit të ligjit në lidhje me drejtësinë e hapur, forcimin e ndërgjegjësimit publik dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik. Këto masa janë në përputhje me agjendën e mirëqeverisjes dhe synojnë t'i japin një shtysë më të mirë zbatimit të Agjendës të Objektiveve të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030.


Planin e Veprimit OGP 2020-2022 bazohet në 4 komponentë, 9 angazhime, 17 masa prioritare dhe 52 produkte/milestones ku 40% e produkteve janë finalizuar, 48% janë në proces dhe 12% do të inicohen bazuar në afatet e parashikuara respektivisht në Planin e Veprimit.




Ky raport pasqyron monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të vitit të parë (2020) për periudhën 2020 dhe gjashtë-mujorin e parë të vitit 2021 (qershor 2021). Raporti i monitorimit/vetëvlerësimi siguron informacion mbi progresin e arritur drejt secilit angazhim, masave prioritare dhe secilit produkt/milestone, angazhimit specifik të bazuar në statusin e arritjes së produkteve dhe treguesve, me qëllim identifikimin e progresit lidhur me zbatimin e reformave kryesore në këtë sektor.

Për këtë periudhë monitorimi, (viti 2020 deri në qershor 2021), të dhënat u mblodhën dhe u analizuan për 52 produktet/milestones përkatësisht në 9 angazhime, 17 masa prioritare dhe për komponentin (C1) antikorrupsion 17 produkte, komponentin (C2) qeverisja digjitale 8 produkte, komponentin (C3) drejtësia e hapur 15 produkte dhe komponentin (C4) qeverisja fiskale 12 produkte. Lidhur me zbatimin e masave prioritare komponenti i antikorrupsionit ka vëllimin më të lartë të zbatimit/finalizimit të produkteve të parashikuara (Masa prioritare 1/K1 kundrejt 29%) lidhur me planet e integritetit, (Masa prioritare 4/K1 vs 14%) lidhur me Pronarët Përfitues dhe Prioritetin e Drejtësisë të Hapur (Masa prioritare 8/K3 kundrejt 14%).


Statusi i Masave Prioritare ne periudhen e monitorimit



Lidhur me arritjet/flagships për të katër (4) komponentët dhe (9) angazhimet vihet re arritje e rezultateve thelbësore që bëjnë ndryshim në reformat e ndërmarra.



Për këtë periudhë 2020 deri në qershor 2021, është identifikuar progres i kënaqshëm në qasjen antikorrupsion (C1), qeverisjen dixhitale (C2), drejtësinë e hapur (C3) dhe transparencën fiskale (C4) në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit, nga të cilat disa nga arritjet përmenden si më poshtë vijon:



Disa nga rezultatet e raportit të monitorimit/ve të vlerësimit:

Manuali (metodologjia) për Planet e Integritetit i hartuar dhe miratuar.

Numri i buletineve për rritjen e transparencës të prodhuara/publikuara (2021/2022): Qershor 2021 e -buletini i publikuar dhe i shpërndarë në linkun: <https://drejtesia.gov.al/e-buletin/>

597 e-shërbime të reja të zbatuara në platformën e-Albania gjatë vitit 2020 dhe gjysmës së parë të 2021.


1,207 shërbime elektronike të ofruara në portalin e-Albania, ose 95% e të gjitha shërbimeve publike.

132 video kryesisht për e-shërbimet dhe mënyrën e përdorimit të tyre.

141 infografi për e-albania, e-shërbimet, si t'i përdorin ato, statistikat e tyre.


30 materiale shpalosëse si kronika televizive, artikuj.

101 grupe të reja të të dhënave të disponueshme në portalin Open Data gjatë vitit 2020 dhe gjysmës së parë të 2021. 212 grupe të të dhënave janë në dispozicion në portalin Open Data.



AKSHI ka kryer një sondazh lidhur me përdorimin e portalit Open Data për sa të kënaqur janë përdoruesit: 46.1% e përdoruesve kanë përdorur të dhënat e hapura për një nismë personale; 41% e përdoruesve të opendata janë shumë të kënaqur dhe 40.9% janë të kënaqur

(81.9% në totalin e përdoruesve të kënaqur); 75.8% e kanë të lehtë qasjen dhe përdorimin e portalit.



18 Anketa të Kënaqshmërisë së Qytetarëve të kryera në ADISA, të cilat treguan se shumica e qytetarëve ishin "të kënaqur" ose "shumë të kënaqur".

- Janë kryer 18 sondazhe që kanë matur kohën e aplikimit të cilat treguan se një kohë mesatare e aplikimit prej 9 minutash (në vitin 2021) u ul 10% nga viti 2020.
- 7 Fokus Grupe u organizuan për të krijuar një kuptim më të mirë të situatës me shërbimet publike nga perspektiva e qytetarëve.
- ADISA ka ngritur 7 Qendra të reja të Shërbimit të Integruar, ku shërbimet publike tani ofrohen duke ruajtur të gjitha standardet evropiane përsa i përket ofrimit të shërbimeve dhe aksesueshmërisë.

Free
Legal
Aid



Themelohet Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Drejtoria ka një staf me kapacitet të mjaftueshëm për të garantuar aftësinë dhe për të ofruar shërbimet e kërkuara nga qytetarët:

- Krijohet dhe është e aksesueshme Webi zyrtar www.ndihmajuridike.gov.al
- juridiksioni.al
- numri jeshil 0801010

Citizen
Budget

Raportet vjetore të ekzekutimit të buxhetit (VF 2019 dhe VF 2020), janë përmirësuar dhe publikuar në faqen e internetit të MFE-së.


- **Raportet e ekzekutimit të buxhetit vjetor** dhe raporti i rishikimit të buxhetit janë përmirësuar dhe publikuar gjatë vitit 2020 dhe 2021.
- **Hartuar dhe publikuar një udhëzues për Buxhetin e Qytetarëve.**
- U përgatit dhe u zbatua **kalendari i seancave dëgjimore të buxhetit me proceset kryesore buxhetore siç ishte planifikuar për vitin 2020.**
- U zhvilluan një sërë **webinaresh online për ngritjen e kapaciteteve me OSHC-të.**

Qasja dhe zbatimi metodologjik për raportin e monitorimit

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 157, datë 22.10.2018 “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndër-sektoriale, si dhe krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të integruar sektorial/ndër-sektorial” Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje luan rolin e sekretariatit teknik të GMIP-së për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik duke koordinuar teknikisht dhe metodologjikisht të gjitha institucionet përgjegjëse të Planit të Veprimit OGP 2020-2022 dhe më pas konsolidon raportin e monitorimit dhe gjithë anekset respektive të raportit.

Ky raport mbulon periudhën nga viti 2020 - qershor 2021 dhe është hartuar bazuar në kontributin e dhënë nga të gjitha institucionet e përfshira në Planin e Veprimit të OGP-së. Qëllimi i raportit është që të identifikojë në mënyrë të konsoliduar progresin dhe mbi arritjet e Planit Kombëtar si dhe eliminuar në këtë pikëpamje sfidat drejt përmbushjes së angazhimeve dhe masave prioritare të planit të veprimit.

Raporti i Monitorimit të Planit të Veprimit është konsoliduar sipas katër fazave kryesore:



Faza 1

- Raportimi nga institucionet përmes LFPs/pikave kryesore fokale mbi zbatimin e masave prioritare/produkteve për të cilat ata janë përgjegjës;

Faza 2

- Analiza e kryer (sasiore dhe cilësore) nga sekretariati teknik GMIP/Mirëqeverisja dhe Administrimi Publik/POC;

Faza 3

- Procesi i konsultimit me të gjithë aktorët kryesorë qeveritatë dhe aktorët kryesorë të OSHC-ve të cilët janë përfshirë si bashkë-krijues në fazën e hartimit të këtij Planit Veprimi;

Faza 4

- Raportimi tek Grupi Tematik i Politikëbërjes mbi zbatimin e Planit të Veprimit në tërësi para Komitetit OGP/GMIP

Çdo institucion raporton mbi nivelin e zbatimit të secilit angazhim, masë prioritare dhe arritje (të bazuar në aktivitetet e kryera), buxhetin e siguruar për vitin raportues, buxhetin e ndarë për periudhën raportuese, problemet e hasura, hapat e mëtejshëm dhe vlerësimin e progresit të plan veprimi në tërësi. Për të monitoruar zbatimin e angazhimeve të ndërmarra, përsa i përket zbatimit të produkteve/milestones, procesi i monitorimit kryhet për secilin komponent/qasje.

Analiza e të dhënave u bazua në standardet e OGP-së/raportet e vetëvlerësimit bazuar në modelet e strukturës dhe gjithashtu duke ndjekur disa instrumente kryesore të monitorimit.

- **Së pari, analizohet zbatimi i produkteve/milestones** (arritja e aktiviteve), duke dhënë një rezultat sasior dhe cilësor të arritjes së tyre kundrejt kryerjes së aktiviteve përkatëse që lidhen me to.
- **Së dyti, është analizuar arritja e vlerës së synuar për 2020/2021** të përcaktuar në treguesit e performancës, duke vlerësuar shkallën e ndikimit të masave të zbatuara në arritjen e vlerës së synuar.
- **Së treti, arritja e masave prioritare** analizohet përmes arritjes së treguesve në lidhje me angazhimet përkatëse të arritura.

Zbatueshmëria e produkteve dhe aktiviteve të Planit të Veprimit klasifikohet me vlerat e mëposhtme:

- Finalizuar/Zbatuar: Institucionet kanë raportuar statusin e "finalizuar/zbatuar" për ato produkte/aktivitete që janë përmbushur.
- Pjesërisht i zbatuar/Në vazhdim: Institucionet kanë raportuar statusin "në vazhdim" për ato produkte/aktivitete, të cilat në periudhën raportuese janë zbatuar pjesërisht dhe/ose vazhdojnë të jenë të zbatueshme prej tyre.
- Nuk kanë filluar të zbatohen: Nuk kanë filluar të zbatohen ato produkte/aktivitetet që nuk kanë shënuar zhvillim për periudhën raportuese sepse iniciimi për to parashihet pas kësaj periudhe raportuese.

1 K


omponenti:Antikorrupsion

Nismat dhe politikat antikorrupsion mbështesin reformat ndërinstucionale të nevojshme për funksionimin dhe efikasitetin e përmirësuar të të gjitha institucioneve publike dhe private. Këto iniciativa dhe politika antikorrupsion do të rrisin integritetin, performancën dhe llogaridhënien e institucioneve dhe promovimin e qeverisjes së përgjegjshme që lehtësojnë zbatimin e barabartë dhe të drejtë të ligjit dhe përmirësojnë shërbimin publik për të gjithë qytetarët, si dhe zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve të qytetarëve në çështjet e pronësisë.






Më specifikisht (i) planet e integritetit dhe (ii) pronarët përfitues janë dy objektiva të këtij plani veprimi, dhe që marrin fokus në reformën antikorrupsion për qeverisje të hapur në kuadër të Planit të Veprimit OGP 2020-2022.

Komponenti anti-korrupsion në kuadrin e zbatimit të Planit të Veprimit OGP 2020-2022 në periudhën 2020 deri në gjashtë-mujorin e parë të vitit 2021 82% të angazhimeve janë përfunduar ndërkohë që 18% janë ende në proces për periudhën në vijim.

Në kuadër të Komponentit të Qeverisjes transparente dhe luftës kundër korrupsionit gjatë zbatimit dhe implementimit të Planit Kombëtar të Veprimit OGP 2020-2022 për periudhën 2020 dhe gjashtë-mujorin e parë 2021 janë realizuar dhe finalizuar 59% të produkteve ndërkohë 12% të produkteve janë në proces për periudhën në vijimësi dhe 29% të produkteve parashikohen të fillojnë në periudhat sipas planit të veprimit.



Ndërkohë lidhur me 4 prioritetet realizueshmëria për prioritetin (3) dhe (4) paraqitet e finalizuar në masën 100%, prioriteti (1) 75% dhe prioriteti (2) ka në proces rreth 20% të produkteve.



Disa nga rezultatet e raportit të monitorimit/ve të vlerësimit:

Manuali (metodologjia) i hartuar dhe miratuar përmes Urdhri nr. 334, datë 07.10.2020;

Numri i buletineve për rritjen e transparencës të prodhuara/publikuara (2021/2022): Qershor 2021 e -buletini i publikuar dhe i shpërndarë në linkun: <https://drejtesia.gov.al/e-buletin/>

Workshope mbi identifikimin e vlerësimit të rrezikut dhe procesit të hartimit të planeve të integritetit: (13 workshope) / Janar -Mars 2021.

Plani i Integritetit të MD –së i miratuar: (urdhri i MD -së, nr. 333, datë 07.10.2020)/Tryeza të rrumbullakëta pune për Planin e Integritetit të MD-së: - (takimi 12 nëntor 2020; takime hibride).

Ministria e Drejtësisë në rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, udhëheq angazhimin ndërinstitucional për të përmirësuar integritetin publik dhe për të promovuar një kulturë, transparencë dhe llogaridhënie për të gjithë nëpunësit civilë dhe zyrtarët publikë në të gjitha nivelet e qeverisë, por veçanërisht në ato më të prekshmet si dhe të sektorëve të ndjeshëm ndaj korrupsionit.

Këto iniciativa janë një shembull shumë i mirë i bashkëpunimit me OSHC-të, të cilat janë bashkë-krijuar me aktorët e interesit në kuadër të Planit OGP 2020-2022. Vlerësimi i riskut të integritetit, takime konsultimi dhe forcim kapacitetes në vlerësimin e riskut, bashkëhartim i planit të integritetit për Ministrinë e Drejtësisë, replikimi i tij në varësitë e MD-së fillimisht dhe në ML-të janë hapa që përmirësojnë luftën kundër korrupsionit, forcojnë integritetin dhe performancën e organeve të administratës si dhe sigurojnë shërbime më të mira për publikun.

Planet e Integritetit janë një instrument i aplikueshëm që forcon dhe përmirëson performancën e institucionve publike, llogaridhënien dhe transparencën e tyre. Ministria e Drejtësisë është institucioni i parë në nivel qendror që ka kryer një vlerësim risku të integritetit dhe ka hartuar një Plan Integriteti. Ky është një dokument model për institucionet e varësisë së saj dhe të ministrive të linjës, një dokument që përfshin risqet e integritetit sipas fushave funksionale të Ministrisë së Drejtësisë dhe janë identifikuar dhe planifikuar aktivitetet konkrete për adresimin e tyre. Qëllimi i tij është përmirësimi i politikave, rregullave, praktikave të parandalimit të korrupsionit, si dhe

forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit. Plani i Integritetit i MD-së do të ndikojë pozitivisht ministrinë e linjës, si edhe institucionet e varësisë, në axhendat e tyre institucionale kundër korrupsionit. Metodologjia e vlerësimit të riskut të integritetit për qeverisjen qendrore, e aplikuar për së pari në Ministrinë e Drejtësisë në vitin 2020, do të jetë një model dhe udhëzues vlerësimi edhe në institucionet e tjera të administratës qendrore.

Nga ana tjetër, krijimi dhe administrimi i vazhdueshëm i Regjistrit të Pronarëve Përfitues përbën një angazhim thelbësor për parandalimin e korrupsionit përmes transparencës së detyrueshme dhe masave të gjurmueshmërisë.

Me qëllim zbatimin e rekomandimeve të Komitetit të Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL) të Këshillit të Evropës dhe angazhimeve të ndërmarra në Planin Kombëtar OGP 2020-2022 Kryeministri ngriti grupin ndërinstitutional të punës për zbatimin e rekomandimeve të MONEYVAL. Në vijim të këtij procesi, ministri i Financave dhe Ekonomisë ngriti ngrupim ndërinstitutional të punës, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të insitucioneve përgjegjëse në varësi të kësaj ministrie dhe pjesë e të cilit ishte edhe Qendra Kombëtare e Biznesit, për ndjekjen, koordinimin dhe raportimin e progresit të masave të përcaktuara në planin e veprimt, për përmbushjen e rekomandimeve të Komitetit të Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL) të Këshillit të Evropës. Ky grup pune kishte për detyrë:

- shqyrtimin e legjislacionit shqiptar;
- vlerësimin e praktikave më të mira;
- hartimin e rekomandimeve për krijimin e Regjistrit të Pronarëve Përfitues.

Për sa më sipër, Ministria e Financave dhe QKB me asistencën e GIZ, bazuar në legjislacionin shqiptar dhe në praktikat e vendeve të huaja, hartuan Ligjin Nr. 112/2020 “Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues”. Gjithashtu Regjistri i Pronarëve Përfitues është ngritur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe AKSHI, dhe administrohet nga QKB-ja.


2 K

omponenti:Qeverisja Digjitale



Qeveria shqiptare ka filluar një rrugë pa kthim drejt sigurimit të shërbimeve publike online dhe dixhitalizimit të plotë të proceseve të punës së administratës. Reduktimi i numrit të dokumenteve shoqëruese të kërkuara për qytetarët / bizneset dhe gjithashtu ri-inxhinierimin e të gjithë procesit të sigurimit të tyre, në mënyrë që të zvogëlohen hapat e përpunimit, të dixhitalizohen proceset e brendshme duke ulur kështu burokracitë, kostot dhe kohën për qytetarët. Centralizimi i shërbimeve publike në platformën e-Albania mundëson rritjen e llogaridhënies publike në tre nivele:

- **Së pari, një platformë elektronike krijon gjurmueshmëri për veprimet e ofrimit të shërbimeve dhe zvogëlon nevojën për kontakte ballë për ballë midis qytetarëve dhe punonjësve të administratës publike duke zvogëluar mundësitë që korrupsioni të ndodhë ose të mbetet pa u vërejtur.**
- **Së dyti, shërbimet publike në platformë duhet të plotësojnë kriteret e mirëpërcaktuara dhe pajtueshmëria me këto kriteret monitorohet gjithmonë. Vendosja dhe zbatimi i një kriteri të unifikuar ndërmjet institucioneve publike eliminon ndryshimet në praktikën administrative nëpër institucione dhe heq paqartësinë dhe për pasojë, jo vetëm që promovon rritjen e efikasitetit në të gjithë administratën publike, por gjithashtu zvogëlon mundësitë për korrupsion dhe keqmenaxhim.**
- **Së treti, platforma e-Albania nuk është një mekanizëm përgjegjshmërie vetëm ndaj institucioneve të brendshme, por edhe përmes mekanizmave të jashtëm që mundësojnë pjesëmarrjen qytetare drejt përmirësimit të saj të vazhdueshëm. Përmes fushatës së ndërgjegjësimit për të aftësuar qytetarët dhe bizneset dhe mekanizmin e saj të feedback (aktiviteti 2), platforma e-Albania promovon një kulturë dhe përjasje me në qendër qytetarin për transformimin e shërbimeve publike. Një platformë elektronike që eliminon reagimet personale ose fizike dhe mbrojtjen e garantuar të privatësisë për qytetarët synon të stimulojë qytetarët.**

Në kuadër të Komponentit të Qeverisjes digjitale gjatë zbatimit dhe implementimit të Planit Kombëtar të Veprimit OGP 2020-2022 për periudhën 2020 dhe gjashtë-mujorin e parë 2021 janë në proces 100% e produkteve ndërkohë asnjë nga 8 produktet nuk konsiderohet i finalizuar për shkak të natyrës specifike që masat paraqesin.



Ndërkohë të tre (3) angazhimet paraqesin një pamje të njëjtë dhe në sinkron nga ku 100% e tyre janë produkte të cilat paraqesin progres dhe janë në proces/në vijimësi në përputhje dhe me afatet e parashikuara në Planin e Veprimit.



Disa nga rezultatet e raportit të monitorimit/ve të vlerësimit:

597 e-shërbime të reja të zbatuara në platformën e-Albania gjatë vitit 2020 dhe gjysmës së parë të 2021.

1,207 shërbime elektronike të ofruara në portalin e-Albania, ose 95% e të gjitha shërbimeve publike.

46.1% e përdoruesve kanë përdorur të dhënat e hapura për një nismë personale; **41% e përdoruesve** të opendata janë shumë të kënaqur dhe **40.9% janë të kënaqur (81.9% në totalin e përdoruesve të kënaqur)**; **75.8% e kanë të lehtë qasjen dhe përdorimin e portalit.**

Raportet mujore të statistikave të publikuara në fund të çdo muaji në portalin e-Albania.

132 video kryesisht për e-shërbimet dhe mënyrën e përdorimit të tyre.

141 infografikë për e-albania, e-shërbimet, si t'i përdorin ato, statistikat e tyre.

30 materiale shpalosëse si kronika televizive, artikuj.

101 grupe të reja të të dhënave të disponueshme në portalin Open Data gjatë vitit 2020 dhe gjysmës së parë të 2021. 212 grupe të të dhënave janë në dispozicion në portalin Open Data.

Më specifikiisht **angazhimi i tretë (3) i komponentit të qeverisjes digjitale lidhet me digjitalizimin e shërbimeve publike, më shumë se 1200 shërbime publike ose 95% e të gjithë shërbimeve publike do të sigurohen në platformën e-Albania.**

Aktualisht, në kuadër të angazhimit respektiv platforma **e-Albania i shërben rregullisht 2.1 milion qytetarëve shqiptarë dhe 85,000 bizneseve. Numri i përdoruesve të regjistruar në portal është 42 herë më i lartë se në vitin 2013. Gjatë vitit 2020 dhe 2021 janë 5.4 milione qytetarë dhe biznese të regjistruar në platformën e-Albania.**

Në kuadër të këtij angazhimi gjatë vitit 2020 dhe gjysmës së parë të vitit 2021 është siguruar që 95% e të gjitha aplikimeve të shërbimeve publik të ofrohen në e-Albania: pa asnjë kosto, pa prituri në radhë në sporte let e shtetit, pa pasur ndonjë kontakt fizik me punonjësit e administratës.

597 shërbime të reja elektronike u implementuan në platformën e-Albania gjatë vitit 2020 dhe gjysmës së parë të vitit 2021. Nga 14 shërbime online në 2013, tani ofrohen 1,2017 shërbime elektronike ose 95% e të gjithë shërbimeve publike.

Përveç aplikimit online të shërbimeve publike në e-Albania, **47 shërbime elektronike mundësojnë gjenerimin e dokumenteve me vulë elektronike dhe 190 shërbime me nënshkrim elektronik.**

Gjatë 2020, janë **7,705,068 aplikime të bëra për shërbime publike dhe 1,210,093 qytetarë dhe biznese të shërbyer.** Rreth **74 herë më shumë shërbime dhe 150 herë më shumë aplikime** në platformën e-Albania krahasuar me 2013.

Aktualisht, 180 institucione publike gjenerojnë dokumente në emër të qytetarëve dhe bizneseve. Deri më tani, janë gjeneruar më shumë se **13 milion dokumente të vulosura elektronikisht, nga të cilat më shumë se 7 milione, nga punonjësit e administratës në emër të qytetarit ose biznesit.** Të gjitha këto iniciativa të transformimit digjital na mundësuan t'iu kursejmë qytetarëve dhe bizneseve më shumë se **500 vjet kohë në tre vitet e fundit, e cila më parë ishte humbur në radhë dhe burokraci të shumta dhe duke u kursyer atyre 4 milion euro.** Vetëm gjatë vitit 2020, u është dhënë shërbimi 1.2 milion qytetarëve duke u kursyer atyre 1.36 milion euro dhe 293 vjet pritje në radhë.

Bizneseve u ofrohen më shumë se 300 shërbime elektronike në platformë, duke filluar nga regjistrimi fillestar i një biznesi të ri, aplikimet për leje ndërtimi dhe licenca, pagesa e taksave ose dorëzimi i bilanceve. Këto janë të gjitha shërbimet e ofruara pa ndonjë kontakt me administratën dhe pa ndonjë kosto shtesë.

Gjithashtu për vitin 2021, janë digjitalizuar aplikimet për të marrë naftë falas, pa akcizë, pa taksë qarkullimi dhe pa taksë karboni për punimet e mekanizuara. Këto rezultate tregojnë se grupe të tilla si fermerët janë të njohur me platformën dhe përdorimin e e-Albania. Nga aplikimet në e-Albania janë kursyer rreth 8 vjet pritje në radhë.

Raporti i Kombeve të Bashkuara për qeverisjen elektronike e rendit Shqipërinë në vendin e 59-të në botë, duke e renditur atë të 15-të në rang botëror për Treguesin e përgjithshëm të Qeverisjes elektronike krahasuar me 2018 kur u botua raporti i fundit. Konkretisht, treguesi është përmirësuar nga 0.6519 pikë në 2018, në 0.7399 në 2020 (vlera më e lartë me të cilën mund të vlerësohet një vend është 1). Përmirësimi i renditjes këtë vit për vendin tonë është arritur përmes nën-indikatorit të shërbimeve online, duke u përmirësuar nga vendi i 62-të në 2018, në vendin e 31-të në 2020. Pra, një rritje me 31 vende në klasifikim në vetëm 2 vjet, me pikë të barabarta me Kanadanë, duke lënë pas vende të tilla si Zvicra, Italia, Gjermania, Greqia, Republika Çeke dhe të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.

Një tjetër angazhim pjesë e këtij komponenti lidhet me të dhënat e hapura. Angazhimi për portalin e të dhënave të hapura, megjithëse është vazhdim i angazhimit të mëparshëm, ka si qëllim kryesor përmirësimin e cilësisë së të dhënave në mënyrë që të ripërdoren nga sa më shumë qytetarë dhe biznese.

Pasurimi i portalit opendata.gov.al me më shumë të dhëna që publikohen drejtpërdrejt nga bazat e të dhënave shtetërore përmes Platformës Qeveritare të Ndërveprimit i siguron shoqërisë civile, studentëve, akademikëve, gazetarëve, bizneseve dhe bizneseve fillestare etj. qasje më të lehtë në të dhëna të ndryshme qeveritare të nevojshme për hulumtime, studime/analiza ose ndërtimin e

bizneseve të tyre dhe rrit transparencën dhe besimin e qeverisë, pasi të dhënat publikohen pa asnjë ndërhyrje njerëzore.

Në të njëjtën kohë, janë planifikuar zhvillime të mëtejshme në mënyrë që të përmirësojnë kategoritë e portalit dhe cilësinë e të dhënave, duke u mundësuar kështu përdoruesve që të kenë më shumë mundësi të të dhënave dhe kërkim më të mirë.

Aktualisht, portali ofron më shumë se 212 grupe të të dhënave në fushat e shëndetësisë, thesarit, buxhetit, doganave, arsimit, biznesit dhe shumë më tepër. Numri i grupeve të të dhënave të reja të disponueshme në Portalin e të Dhënave të Hapura gjatë vitit 2020 është 101 grupe të dhënash.

Grupet e të dhënave më të shkarkuara janë:

Institucioni	Kategoria e të dhënave	Downloaded
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Thesari (Pagesat e bëra nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit)	1153
Qendra Kombëtare e Biznesit	Bizneset e regjistruara sipas qyteteve	986
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Lista e medikamenteve	653
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Statistikat për importin e karburantit, kafesë dhe birrës	432
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor	Statistikat për automjetet sipas: karburantit, modelit, kapacitetit etj.	174
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor	Statistikat për automjetet e regjistruara	168

Gjithashtu një angazhim i fundit në këtë komponent që ka të bëjë me përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike duke u fokusuar në marrjen në konsideratë të nevojave të ofrimit të shërbimeve publike të të gjithë qytetarëve dhe përfshirjen e këtyre nevojave në veprime të qarta. Kjo qasje e shtuar është e mundur vetëm kur ofruesit e shërbimeve publike u ofrojnë qytetarëve mundësinë për të kontribuar në këto ndryshime. Ky angazhim krijon mekanizma për reagime të vazhdueshme nga qytetarët. Përmes sondazheve të qytetarëve për kënaqësinë e qytetarëve në qendrat ADISA (pika referim 1) dhe për kohën e duhur të proceseve të aplikimit në këto qendra (pika referimit 2) qytetarët do të inkurajohen të japin reagime të sinqerta.

Gjatë periudhës raportuese Anketa e Kënaqësisë së Qytetarëve u krye në 18 qendra ADISA, e cila tregoi se shumica e qytetarëve ishin "të kënaqur" ose "Shumë të kënaqur" me shërbimin e marrë në sportelet e aplikimit. Niveli i kënaqësisë me shërbimet publike ishte në vlerat 68% midis të anketuarve që kishin kontaktuar të paktën një institucion gjatë 12 muajve të fundit.

Gjithashtu Sondazhi "Besimi në Qeverisje" i financuar nga UNDP u krye nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) gjatë muajve Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2020 në 61 bashkitë e Shqipërisë duke përdorur një kampion prej 2500 përfaqësues të zgjedhur në mënyrë rastësore. **Krahasuar me vitin 2019, një përqindje më e lartë e popullsisë shqiptare raportoi të vizitonte një nga Qendrat e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) (29% kundrejt 24%). Midis atyre që vizituan një Qendër të shërbimit ADISA, 73.4% treguan se ishin 'të kënaqur' ose 'shumë të kënaqur' me shërbimin që morën, një rritje prej më shumë se 4 p.p. krahasuar me vitin e kaluar.**

Gjithashtu u organizuan Fokus Grupe për të krijuar një kuptim më të mirë të situatës me shërbimet publike nga këndvështrimi i qytetarëve. Në mënyrë që të sigurohej cilësia e të dhënave, u përdor një pyetësor i shqyrtimit për procesin e realizuar. Pyetësori përfshinte të gjitha pyetjet përkatëse të nevojshme për të siguruar që të gjithë pjesëmarrësit e grupeve të fokusit të futen në profilin e duhur.

Gjatë periudhës së raportimit (2020-2021), ADISA ka ngritur 7 Qendra të reja të Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara. ADISA aktualisht është e pranishme në 20 bashki¹, ku shërbimet publike ofrohen duke ruajtur të gjitha standardet evropiane për sa i përket ofrimit të shërbimeve dhe aksesueshmërisë.

Lidhur me rritjen e aksesit në procesin e ofrimit të shërbimit publik për grupet e marginalizuara dhe të ndjeshme, ADISA vazhdon zgjerimin në territor me Qendrat e reja të Integruara në përputhje me standardet e aksesueshmërisë Gjithashtu me mbështetjen e UNDP, ADISA do të trajtojë sportelistët e të gjithë qendrave për të ofruar shërbime për personat me aftësi të kufizuara. Qëllimi i përgjithshëm i këtij procesi është të kontribuojë përmes rritjes së kapaciteteve në përmirësimin e njohurive dhe aftësive të stafit të administratës publike në shërbimin e personave me aftësi të kufizuara, përfshirë ato fizikë dhe kognitivë, duke siguruar trajtim që u përgjigjet nevojave të tyre të veçanta, dhe duke rezultuar në ofrim më të efektshëm dhe të kënaqshëm të shërbimit publik nga këndvështrimi i tyre. Ky proces do të përfundojë brenda muajit tetor të vitit 2021.

¹Kavajë, Krujë, Shkodër, Gjirokastrë, Fier, Lushnje, Tirana 2, Kukës, Elbasan, si dhe në Zyrat ADISA në Maliq, Belsh, Librazhd, Divjakë, Patos, Malësi e Madhe, Pogradec, Mat, Roskovec, Kolonjë dhe Tepelenë.


3 K

omponenti: Drejtësia e Hapur


Transparenca, llogaridhënia dhe aksesin në drejtësi janë parimet kyçe operacionale të njohura për mirëqeverisjen, duke përbërë kështu shtyllën kryesore të demokracisë. E drejta e aksesit në drejtësi është parimi kushtetues me anë të të cilit garantohet ushtrimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, një kusht esencial për ekzistencën e shtetit të së drejtës, që udhëheq organizimin dhe mirëfunksionimin e drejtësisë në vend.

Me iniciimin e Reformës në Drejtësi, një reformë e thellë që po prek në tërësi çdo element të sistemit aktual të drejtësisë, u iniciua edhe një reformim i sistemit të ndihmës juridike, duke ofruar një frymë të re, në sinkron me kërkesat dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe si një mekanizëm lehtësues që përdoret për të rritur aksesin në drejtësi për grupet që nuk kanë mundësi financiare për të paguar tarifën ligjore pranë organeve/gjykatave dhe njëkohësisht për të mundësuar këshillim ose mbrojtje ligjore. Programet e ndihmës juridike falas synojnë të sjellin sistemin e drejtësisë më afër nevojës së qytetarëve. Për këtë arsye ky komponent është përqëndruar në sigurimin e mjeteve juridike efektive por edhe të arritshme dhe të përballeshme për zgjidhjen e problematikave. Në këtë kuadër duhet theksuar se pavarësia e sistemit gjyqësor dhe integriteti i tij, janë një parakusht thelbësor për të siguruar që nuk ka diskriminim në administrimin e drejtësisë. Në përgjigje të nevojave dhe problematikave u synua ndërmarrja e angazhimeve duke përfshirë një qasje të trefishtë mbi aksesin, transparencën dhe llogaridhënien. Puna e realizuar në kuadër të këtij komponenti ka vijuar me prioritet me qëllim identifikim të sfidave dhe përmirësimin e hapave të mëtejshëm për një proces zbatueshmërie efektiv.

Në kuadër të Komponentit të Qeverisjes për Drejtësi të Hapur gjatë zbatimit dhe implementimit të Planit Kombëtar të Veprimit OGP 2020-2022 për periudhën 2020 dhe gjashtë-mujorin e parë 2021 janë finalizuar rreth 73% të produkteve, ndërkohë 20% janë në proces dhe ndërkohë 7% e tyre nuk kanë filluar implementimin.



Ndërkohë të dy (2) angazhimet paraqesin progres të konsiderueshëm në kuadër të produkteve të finalizuara në raport me produktet në proces apo produktet të cilat nuk kanë nisur ende në përputhje dhe me afatet e parashikuara në Planin e Veprimit.



Disa nga rezultatet e raportit të monitorimit/ve të vlerësimit:

Themelohet Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Drejtoria ka një staf me kapacitet të mjaftueshëm për të garantuar aftësinë dhe për të ofruar shërbimet e kërkuara nga qytetarët.

Krijohet dhe është e aksesueshme Webi zyrtar www.ndihmajuridike.gov.al/juridiksioni.al
numri jeshil 0801010

Realizuar moduli i parë të trajnimit të detyrueshëm të punonjësve të Qendrave Primare të Ndihmës Ligjore.

Përcaktohen rregulloret dhe programi mësimor për trajnimin dhe metodat e provimit për testimin e kandidatëve për ndërmjetësim. (Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësuesve).

Projektimi i bazave të të dhënave elektronike. (Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësuesve).

Më specifikisht lidhur me ndihmën juridike falas përgjatë periudhës Janar-Qershor 2021, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile që kanë në fokus të tyre mbrojtjen e të drejtave ligjore të qytetarëve është bërë e mundur nënshkrimi i 3 (tre) marrëveshjeve të bashkëpunimit “Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe konkretisht:

- Marrëveshje bashkëpunimi me nr. 13/4 prot., datë 07.01.2021, me Organizatën Drejtësi Sociale;
- Marrëveshje bashkëpunimi me nr. 1643 prot., datë 27.05.2021, me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shkodër
- Marrëveshje bashkëpunimi me nr. 498 prot., datë 26.05.2021, me Shoqatën e Invalidëve të Punës.

Në mbështetje të Marrëveshjes për zbatimin e projektit, “Shtirirja e shërbimeve të ndihmës ligjore falas për gratë dhe burrat në Shqipëri” midis Ministrisë së Drejtësisë, UNDP dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA), si dhe në zbatim të Letrës së Bashkëpunimit (Korrik 2020-Maj 2022), është bërë e mundur hapja dhe kalimi nën administrim të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas i 8 (tetë) qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore në të cilat ushtrojnë funksionet aktualisht 14 (katërmëdhjetë) punonjës me trajnim të posaçëm në qytetin e Durrësit, Fierit, Lezhës, Gjirokastrës, Pogradecit, Dibrës, Shkodrës dhe Vlorës.

Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve si një mekanizëm alternative për qytetarët për zgjidhjen e problemeve ligjore ka forcuar bashkëpunimin ndër-institucional me Ministrinë e Drejtësisë në kuadër të rritjes dhe përmirësimit të kapaciteteve profesionale të ndërmjetësve përmes organizimit të trajnimeve fillestare dhe vazhduese. Në këtë kuadër janë përcaktuar dhe miratuar rregulloret mbi trajnimet dhe metodat e provimit për testimin e kandidatëve ndërmjetës.

4 K

omponenti:Qeverisja Fiskale

Qeveria shqiptare ka vazhduar të punojë me synim sigurimin e një progresi të kënaqshëm në lidhje me disponueshmërinë publike të një informacioni buxhetor të arritshëm, në kohë, gjithëpërfshirës.

Gjatë vitit 2020 është arritur një progress i mire dhe të gjithë targetet e rezultateve të performancës janë përmbushur. Targeti i treguesit “Llogaritë Kombëtare të Qeverisë” u përmbush 75%. Është arritur treguesi “Deklaratë e përmirësuar e riskut fiskal”. Bazuar në targetet e 2020 (+4 ndërmarrje shtetërore të tjera), Njësia e Riskut Fiskal, ka mbledhur të dhëna financiare nga UKT, Hekurudha Shqiptare, Posta Shqiptare, Albgaz dhe po analizon dhe përgatit analizën financiare përkatëse. Target i vitit fiskal 2020 për treguesin *Publikimi raporteve financiare që përmbajnë informacion të arritshëm financiar dhe jo-financiar të performancës* është arritur. U implementuan plotësisht formatet e reja për Raportin Vjetor të Ekzekutimit të Buxhetit dhe raportit brenda vitit.

Në kuadër të Komponentit të Qeverisjes për transparencë fiskale gjatë zbatimit dhe implementimit të Planit Kombëtar të Veprimit OGP 2020-2022 për periudhën 2020 dhe gjashtëmuorin e parë 2021 janë në proces 100 të % të produkteve. Gjithashtu situata paraqitet e njëjtë dhe në kuadër të implementimit të 5 masave prioritare.

Disa nga rezultatet e raportit të monitorimit/ve të vlerësimit:

Disa module të Sistemit të Automatizuar të Sistemit automatik të hartimit të buxhetit të qeverisë u testuan gjatë vitit 2020 dhe puna do të vazhdojë deri në fund të vitit 2021 kur pritet që sistemi të funksionojë.

INSTAT dërgoi në Eurostat "Tabela 1100 - Shpenzimet e përgjithshme të qeverisë sipas funksionit" duke filluar nga të dhënat e vitit 2017 e tutje, por me sistemin e ri të IT që pritet të funksionojë deri në fund të vitit 2021, cilësia, saktësia dhe mbulimi i kësaj tablele do të rritet.

INSTAT publikoi “Politikat e Rishikimit të Harmonizuara për Statistikat Makroekonomike” që synon të përmirësojë respektimin e parimit të dyfishtë të përafrimit midis fushave statistikore në nivelin kombëtar dhe shtrirjes së koordinuar midis vendeve në nivelin e BE-së.

FRU ka vazhduar të monitorojë rreziqet kryesore dhe ka mbledhur informacion nga kompanitë e sektorit të energjisë dhe gjithashtu nga UKT, Albanian Hekurudha, Posta Shqiptare, Albgas

Analizat e NSH-ve kryesore përfshihen në të gjitha raportet periodike të MFE/DMB-së.

Raportet vjetore të ekzekutimit të buxhetit (VF 2019 dhe VF 2020), janë përmirësuar dhe publikuar në faqen e internetit të MFE-së.

Raportet e ekzekutimit të buxhetit vjetor dhe raporti i rishikimit të buxhetit janë përmirësuar dhe publikuar gjatë vitit 2020 dhe 2021.

Hartuar dhe publikuar një udhëzues për Buxhetin e Qytetarëve.

U përgatit dhe u zbatua kalendari i seancave dëgjimore të buxhetit me proceset kryesore buxhetore siç ishte planifikuar për vitin 2020.

U zhvilluan një sërë webinaresh online për ngritjen e kapaciteteve me OSHC-të.

Dy workshope u zhvilluan në Nëntor dhe Dhjetor 2020; Më 6 korrik 2021, MFE organizoi një takim me përfaqësues të shoqërisë civile, në kuadër të buxhetimit me pjesëmarrje të Dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, Faza Strategjike.

Në vitin 2020, u zhvillua procesi i përzgjedhjes së konsulentit që do të ndihmojë MFE në hartimin e akteve ligjore dhe standardeve të kontabilitetit.

Në vitin 2021 ka filluar procesi i përkthimit të standardeve të kontabilitetit.

Ministria e Kulturës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar kanë regjistruar inventarin e aseteve në modulën e aseteve në AGFIS, gjatë vitit 2020.

Më specifikisht lidhur me komponentin fiskal gjatë vitit 2020 përmbajtja, skema dhe formati për raportin vjetor të ekzekutimit të buxhetit VF 2019, është azhurnuar (duke përfshirë produktet) dhe është publikuar në faqen e internetit të MoFE². Raporti është i aksesueshëm në format Excel-idhe Word-i në varësi të natyrës së informacionit.

Gjatë vitit 2021, formati për raportin vjetor të ekzekutimit të buxhetit VF 2020, është azhurnuar (duke përfshirë KPI) dhe është publikuar³. Raporti është i aksesueshëm në format Excel-idhe Word-i në varësi të natyrës së informacionit.

Gjithashtu përmbajtja, skema dhe formatet për raportet e ekzekutimit të buxhetit brenda vitit dhe raportin e rishikimit (përfshirë produktet për çdo LM/BI) janë përmirësuar dhe publikuar⁴. Raportet janë të aksesueshme në format Excel-i dhe Word-i në varësi të natyrës së informacionit.

Gjatë vitit 2021, formati për raportet e ekzekutimit të buxhetit në vit dhe raportin e rishikimit për vitin 2021, është përditësuar (duke përfshirë KPI) dhe është publikuar⁵. Raportet janë të aksesueshme në format Excel-i dhe Word-i në varësi të natyrës së informacionit.

Në kuadër të angazhimit të qytetarëve në planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit një udhëzues për Buxhetin e Qytetarëve është zhvilluar dhe publikuar⁶. Qëllimi kryesor i udhëzuesit është të përmirësojë angazhimin e qytetarëve, OSHC-ve dhe grupeve të tjera të interesit në procesin e buxhetit të qeverisë. Një kalendar i seancave dëgjimore lidhur me buxhetin dhe proceset kyçe të

²<https://www.financa.gov.al/analizat-e-monitorimit-te-performances-2019/>

³<https://www.financa.gov.al/34185-2/>

⁴<https://www.financa.gov.al/paketa-e-projektligjit-te-buxhetit-faktik-2019/> ;

<https://www.financa.gov.al/buxheti-2019/>

⁵<https://www.financa.gov.al/paketa-e-projektligjit-te-buxhetit-faktik-2020/> ;

<https://www.financa.gov.al/buxheti-2020/>

⁶<https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2020/11/CB-2021.pdf>

buxhetit u përgatit dhe u zbatua siç ishte planifikuar për vitin 2020. Në këtë drejtim një seri trajnimesh për ngritjen e kapaciteteve me organizata të shoqërisë civile u realizuan në fund të vitit 2020.

Trajnimet synuan rritjen e kapaciteteve të OSHC-ve për të kuptuar buxhetin e shtetit, dhe forcimin e kapaciteteve të tyre për të luajtur një rol vëzhgues për financat publike. Seria e trajnimeve filloi me dy trajnime të mbajtura përkatësisht në nëntor dhe dhjetor 2020, dhe e para u përqëndrua në ciklin e buxhetit dhe pikat hyrëse për avokimin e OSHC-ve; ndërsa e dyta në fazat e ndryshme të kalendarit buxhetor dhe sigurimin e aftësive për vlerësimin sektorial të buxhetit për OSHC-të. Trajnimet u mbajtën në distancë, për shkak të kufizimeve që kishin të bënin me Covid-19 dhe niveli i pjesëmarrjes ishte i kënaqshëm (uebinari i parë: 16 persona nga OSHC të ndryshme dhe MFE; uebinari dytë: 17 persona). Webinaret në internet lejuan të arrijnë një game më të gjerë të OShC-ve.

Një kalendar dëgjimi buxhetor me proceset kyçe të buxhetit u përgatit dhe u zbatua siç ishte planifikuar për vitin 2021. Në këtë drejtim, më 6 korrik, Ministria e Financave dhe Ekonomisë organizoi një takim me përfaqësuesit e shoqërisë civile, në kuadër të buxhetimit me pjesëmarrje të Dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, Faza Strategjike. Në këtë takim u diskutua propozimi për shpërndarjen e burimeve buxhetore në përputhje me politikat e programeve buxhetore për periudhën 2022-2024, duke u përqëndruar në pozicionin e shoqërisë civile mbi këtë propozim. Takimi u mbajt përmes platformës Webex, për shkak të kufizimeve të lidhura me Covid-19 dhe niveli i pjesëmarrjes ishte i kënaqshëm (17 persona nga OSHC të ndryshme). Sipas fushës së përgjegjësisë, për pjesën e dokumentave buxhetore (si p.sh ligji vjetor i buxhetit apo PBA) në rastet kur janë organizuar takime me shoqërinë civile, janë bërë përmbledhje dhe raportet janë publikuar në website.

